



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.75 dt.05.06.1998

**MBI
DISA MASA PER PERMIRESIMIN E METEJSHEM TE PASTRIMIT
NE QYTETIN E TIRANES.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.05.06.1998, pasi bëri analizën : “Gjendja e pastrimit të qytetit të Tiranës gjatë vitit 1997 dhe masat për përmirësimin e saj”, bazuar në ligjin Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” dhe ligjit Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij,

VENDOSI

1. Për përsosjen e mëtejshme të organizimit dhe drejtimit të shërbimeve të pastrimit

1.Ti sugjerohet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit rishikimi dhe përmirësimet e nevojshme në Udhëzuesin Nr.1750, dt.06.06.1995 “Për detyrat e supervisorëve për shërbimet publike në fushën e pastrimit të qytetit dhe qendrave të banuara”.

Drejtoria e P.P.P. dhe Drejtoria Juridike, 30 Qershor 1998.

2.Të caktohen dy supervisorë nga Ndërmarrja e Kuartalleve dhe Gjellbërimit, të cilët duke zbatuar rregulloren e posaçme të bëjnë kontrollin e plotë në ndërmarrje, duke vendosur penalitete për punë të pa kryer ose me cilësi të dobët njëlloj

si për firmat e pastrimit.

Drejtoria e P.P.P. Shërbimeve dhe Drejtoria e P.Personel Organizim, 30 Korrik 1998.

3.Ndërmarrja e Kuartalleve të mbështetet me personel më të kualifikuar, me ambjente të përshtatshme dhe të riorganizohet më mirë për përmbushjen e detyrave funksionale për të cilën është ngritur.

Drejtoria P.P.P. Shërbimeve , Drejtoria e Përgj.Personel Organizimit, vazhdimisht.

4.Të studiohen tregjet dhe parkingët e pa ligjshëm, që kompromentojnë pastrimin e të kërkohet legalizimi për ato që janë të arsyeshme dhe të bëhet pastrimi nga Ndërmarrja e Tregut të Lirë.

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, 30 Qershor 1998.

5.Përmirësimi i rrjetit të informacionit nëpërmjet super - vizorëve komunalist, kryepleqve të mjedisit, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse, si dhe shoqatave të mjedisit dhe popullatës të jetë më i organizuar, më e shpejtë dhe më i plotë, për të zgjidhur shqetësimet për pastrimin.

Drejtoria P.P.P. Shërbimeve, Drejtoria Shëndetësisë dhe Mjedisit. Njësitë administrative , vazhdimisht.

2. Çelja e fondeve nga të ardhurat e Bashkisë për ndërmarrjet e Pastrim Gjelbërimit për vitin 1998.

1.Të miratojë çelje fondi me vlerë **15 milion lekë** për blerjen e **350-400 copë kazana 1.100 litra** për nevojat e Nd.së Kuartalleve, Mjedisit Studentor dhe Tregut të Lirë.

Drejtoria P.P.P Shërbimeve, Drejtoria e Zh.Ekonomik, Drejtoria e Financës, 30 Qershor 1998.

2.Të miratojë çelje fondi **7 milion lekë** për blerjen e 1(një)traktori për Ndërmarrjen e Përpunim Plehut.

Drejtoria P.P.P. Shërbimeve, Drejtoria Financës, 30 Qershor 1998.

3. Detyra për firmat e pastrimit

1.Të kërkohet zbatimi me rigorozitet i detyrimeve kontraktuale, të kërkohet plotësimi i mjeteve teknologjike të duhura për përmirësimin e punës, dhe të penalizohen punimet e pa kryera. Drejtoria P.P.P. Shërbimeve, vazhdimisht.

2.Të detyrohen firmat që të bëjnë financime për edukimin dhe ndërgjegjësimin publik të qytetarëve nëpërmjet shtypit, radios, TV, bisedave dhe anketave në lagje, shkolla, ndërmarrje, institucione etj.

Drejtorja P.P.P. Shërbimeve, vazhdimisht.

3.Në bashkëpunim me firmat, ndërmarrjet, njësitë administrative dhe hallkat e tjera, të bëhet studimi për pastrim model në një lagje pilot.

Drejtorja P.P.P. Shërbimeve, njësitë administrative , Tetor 1998.

4.Të merren masa që pronarët e lokaleve, firmat tregëtare të pajisen me kazanë **40-120 litra** për nevojat e tyre vetiake. Në rast mos zbatimi Inspektoriati i Mjedisit të zbatojë sanksionet ligjore që atyre u jep ligji.

Drejtorja Shëndetësisë dhe Mjedisit , 30 Qershor 1998.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI